

**05.03.2022  
Ora 12:06**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në Bashkinë Shkodër, për zgjedhjet e pjeshtme vendore të datës 6 Mars 2022”.**

**PJESËMARRJA :**

**• KQZ**

**1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Z. Ilirjan Celibashi**

**2.Stafi KQZ:**

**Y. Merkaj, E. Meta**

**• Parti Politike:**

**PD, Koalicioni “Sh-L”**

**Z. I. Celibashi:** Mirëmëngjes të gjithëve! Atëherë fillojmë me seancën publike. Kemi në shqyrtim kërkesën e kryetares së Bashkisë Shkodër për të marrë autorizimin për të bërë zhvendosjen e disa qendrave të votimit.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Celibashi! Përpara se të fillojmë shqyrtimin e kësaj kërkeze të ripërsëritur të Bashkisë Shkodër, do donim që të njiheshim në fakt me tri aktet, të cilat mendojmë se janë të rëndësishme për ne si subjekt zgjedhor. Së pari kërkojmë që të na vihet në dispozicion shkresa e Bashkisë Shkodër për caktimin e qendrave të votimit, në përpunje me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 2, datë 22 janar 2022, të Komisionit Rregulator. Së dyti kërkojmë të njihemi me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që ka rrëzuar kërkesën e mëparshme të Bashkisë Shkodër, për ndryshimin e qendrave të votimit, dhe së treti kërkojmë që të njihemi, qoftë edhe me versionin e shkurtuar të vendimit të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve të ditës së djeshme, që ka rrëzuar

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

ankimin që ka bërë Bashkia Shkodër ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Mendojmë që këto tri akte janë shumë të rëndësishëm edhe për procesin që po zhvillojmë, por edhe ne si subjekt zgjedhor, në mënyrë po themi, që t'i përgjigjemi kësaj, të japim mendimin tonë mbi këtë kërkesë. Nga ana tjetër, ku unë kam pasur një komunikim me anëtarët e KZAZ-së, të cilët në fakt, megjithëse nga ana juaj, ose të paktën nga një komunikim i mëparshëm që patëm, u relatua fakti që ka pasur një lloj dakordësie, të cilët më kanë pohuar që nuk ka asnje lloj dakordësie për ndryshimin dhe nuk kanë informacion sesi është sjellë ajo kërkesë që së bashku me ju patëm mundësi të shohim përpara kësaj seance. Kështu që do kërkoja që kjo seancë të shtyhej deri në momentin që këto akte që kërkuam të na viheshin në dispozicion, dhe kjo paqartësi, ose kjo pyetje që është krijuar në raportin me KZAZ-në përkatëse, të sqarohej plotësisht. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit! Po, përfaqësuesi i koalicionit!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit “SH-L”:** Duke qenë se jemi një ditë përpara procesit zgjedhor, gjersa bashkitë e përcaktuara me dekretin e Presidentit të Republikës, i nderuar zoti kryetar, do të kishim gjithë kohën në dispozicion për të marrë aktet e kérkuara. Një pjesë e tyre janë dhe publike tashmë tek faqja e KQZ-së, nuk shoh pse duhet të kemi vonesa të mëtejshme nga momenti që siç e thashë në fillim jemi vetëm një ditë përpara procesit zgjedhor dhe në bazë të vendimmarjes suaj i gjithë mekanizmi i bashkisë dhe të vetë personave të ngarkuar me detyra zgjedhore duhet të vihet në lëvizje në mënyrën sa më të shpejtë për të përbushur detyrat që i janë ngarkuar. Po ashtu vë në vëmendjen tuaj dhe të komisionit në këtë rast, faktin që ka ardhur një kërkesë ditën e djeshme nga anëtarët e ZAZ-së, e firmosur nga katër anëtarë, nga zonja Brunilda Dibra, nga zoti Gazmir Jahiqi, Erzen

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

Tokaj dhe Marjan Ndërshtiqaj, të cilët japidin dakordësinë e tyre për shkak të pamundësisë, të themi, për shkak të kushteve klimaterike. Japidin dakordësinë e tyre në mënyrë që këto qendra të kërkuara nga ana e Bashkisë Shkodër të zhvendosen në ambiente sa më të përshtatshme, dhe më të aksesueshme. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë qartë, edhe pse argumenti juaj qëndron në lidhje me mundësinë e pasjes së këtij dokumentacioni, jam i detyruar ta respektoj kërkesën e kolegut tuaj, për t'ia vënë në dispozicion këtë dokumentacion. Kështu që po shtyjmë seancën për 20-30 minuta. Erion, bëj gati të gjithë materialin! Atëherë për 30 minuta maksimumi takohemi përsëri në sallë, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

**Rifillon seanca**

**Ora 12:51**


**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë rifillojmë seancën. Dokumentacionin e kërkuar ua dorëzuam, ua shpërndamë përfaqësuesve të partive, Erion?

**Z. E. Meta:** Po!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, besoj përfaqësuesi i Partisë Demokratike do të marrë fjalën në lidhje me çështjen dhe vazhdojmë më tej. Faleminderit!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Komisioner! Së pari më lejoni që në emër të subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, them se ne jemi totalisht kundër ndryshimit të qendrave të votimit në më pak se 24 orë nga fillimi i procesit zgjedhor të 6 Marsit 2022. Siç besoj Komisioni Qendor i Zgjedhjeve është tashmë në dijeni, në Bashkinë Shkodër ka filluar shpërndarja e materialeve zgjedhore. Do mjaftonte ky fakt që kjo kërkesë të ishte *prima facia*. Pra, pa i hyrë shqyrtimit të saj, e rrëzueshme dhe e papranueshme. Më lejoni tani të parashtroj të gjithë argumentet, të cilët në vlerësimin tonë janë të mjaftueshme që kjo kërkesë të rrëzohet nga Komisioni Qendor i Zgjedhjeve, siç ka vepruar me vendimin nr. 116, datë 2 mars 2022, dhe siç ka vepruar Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në datën 4 mars 2022. Së pari, është fakt i njohur publik se kryetarja në detyrë e Bashkisë Shkodër, zonja Voltana Ademi është e përfshirë në fushatën zgjedhore të një kandidati, të një prej kandidatëve. Kështu që çdo kërkesë e zonjës Ademi duhet parë në prespektivën që është kërkesë pale. Pra, nuk duhet parë që është institucioni që po parashtron kërkesën, por është kërkesa e një pale që po i paraqitet Komisionit


*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

Qendror të Zgjedhjeve, kjo e para. E dyta, unë kërkova nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe m'u vu në dispozicion një shkresë, e datës 28 janar 2022, e nënshkruar nga zonja Voltana Ademi, me numër protokolli 1165/1, nëpërmjet së cilës ka njoftuar qendrat e votimit. Besoj që në datën 28 janar 2022, zonja Voltana Ademi e dinte që ishin të njëjtat kushte siç ajo parashtron në letrën e datës 4 mars. Pra, a e dinte zonja Voltana Ademi që në periudhën mars 2022 mund të kishte reshje dëbore? Më lejoni t'ju them zoti Komisioner, se unë jam edhe me origjinë nga ato zona, që në ato zona reshje dëbore ka pothuajse gjatë gjithë vitit. I bie që në ato zona mos të zhvillohen ndonjëherë procese zgjedhore, por të shkojmë me logjikën që atje ka reshje dëbore. Infrastruktura rrugore, edhe vështrësitet, po themi që ka, ose mangësi që ka infrastruktura e rregulluar e asaj zone dihen. Nuk besoj që jemi këtu përpara ndonjë fakti të ri. Pra, nuk është se në atë zonë nuk ndodh asnjëherë të ketë reshje dëbore, dhe papritur në datën 4 mars u zgjuar kryetarja e bashkisë dhe konstatoi se paska reshje dëbore. Në Shalë, në Shosh, në Pult ka vazhdimisht reshje dëbore. Pothuajse në  $\frac{3}{4}$  e gjithë vitit ka reshje dëbore. Kështu që këto kushte, po themi, që parashtrohen, në fakt vijnë në kushtet kur zonja Voltana Ademi ishte në të njëjtat kushte që ka qenë në datën 28 janar, edhe në datën 4 mars. Nuk e kuptojmë se çfarë ka ndodhur në qëndrimin e zonjës Ademi për të kérkuar tashmë ndryshimin. Në fakt jam i habitur nga kjo kérkesë e zonjës Ademi, se rruga atje qenka e prishur dhe nuk funksionoka, do duhej që zonja Ademi, e cila ka qeverisur Bashkinë Shkodër për 7 vite t'u kérkonte falje qytetarëve që në 7 vite nuk ka garantuar një infrastrukturë më të mirë rrugore. Kjo do bënte sens. Po që të vijë këtu dhe të kérkojë që për banorët e atyre zonave, t'iu hiqet qendra e votimit edhe pse ka 7 vite që nuk ua ka rregulluar rrugën këtë po themi, do duhej që zonja Voltana Ademi t'ua shpjegojë banorëve të atyre zonave, por nuk dua të ndalem tek kjo gjë. Unë besoj që fokusi i diksutimit, zoti Komisioner, duhet të jenë parashikimet e nenit 62 të Kodit

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

Zgjedhor, dhe nenit 9, të udhëzimit nr. 1, datë 5 dhjetor 2020, që përcaktojnë se çfarë është, si formohet, ose si ngrihet një qendër votimi dhe kur mund të ndryshohet ajo. Besoj që këtu tani jemi të gjithë të qartë se si formohet dhe ku formohet një qendër votimi, por ajo që duhet t'u kushtojmë vëmendje ku mund të ndryshohet një qendër votimi. Kodi Zgjedhor dhe udhëzimi i Komisionit Regulator janë të qarta, thotë "Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve". Në vendimin e Komisionit Rregulator për përcaktimin e afateve të posaçme proceduriale nuk është prekur kjo pikë. Kështu që përfekt të procesit zgjedhor duhet ta konsiderojmë në fuqi, që 40 ditë përpëra datës së zgjedhjeve nuk ndryshohet qendra e votimit, me përjashtim të rasteve kur kemi të bëjmë me forcë madhore. Këtu besoj që një pjesë e mirë e jona janë, po themi me formim juridik, dhe e kuptojnë që forca madhore është ose fatkeqësia natyrore, ose tërmeti, ose përbashtjet, ose epidemja, por fakti që në një zonë të caktuar ka reshje dëbore në një zonë ku gjithmonë ka reshje dëbore, nuk futet në kushtet e forcës madhore. Nuk futet në kushtet madhore as fakti që infrastruktura rrugore ka probleme. S'kanë sesi të janë rastet e forcës madhore. Pra, jemi në kushtet e qarta i nderuar, që jemi më pak se 24 orë përpëra datës së zgjedhjeve dhe nuk kemi asnjë forcë madhore që do të legjitimonte pranimin e kësaj kërkesë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Unë besoj që është e zezë në të bardhë, po themi përpërcaktimet e ligjit. Ecim pak më tutje. E thashë edhe më përpëra, në datën 2 mars 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë një vendim, i cili ka rrëzuar një kërkesë, po të zonjës Ademi, përfundimisht qendrat e votimit, sepse në fakt dhe këtu duhet kuptuar dhe qëllimi i zonjës Ademi, në fakt qendrat e votimit që ishin propozuar në atë shkresë, nuk ishin gjë tjetër veçse zyrat elektorale të një prej kandidatëve. Pra, kryetarja e Bashkisë Shkodër, me autoritetin e saj, i lejon vetes që të propozojë që qendrat e votimit të hiqen nga zonat ku kanë qenë në shumë procese

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

zgjedhore, dhe sigurisht në zgjedhjet e fundit, do të zhvendosen në zyra elektorale të një kandidati. Kjo është jo vetëm e paligjshme, është gati-gati absurde. Është një përpjekje e qartë për të manipuluar, për të minuar një proces zgjedhor që do zhvillohet ditën e nesërme. Ka pasur një vendimmarrje të KAS-it, është ky vendim, vendimi nr. 11, datë 4 mars 2022, i cili ka vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore pikërisht të Bashkisë Shkodër, sepse ka arsyet e tij, të njëjtat arsyenë fakt që qëndrojnë edhe për kërkesën që është paraqitur dje dhe po shqyrtohet sot përpara Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Është kerkuar ndryshimi i 11 qendrave të votimit. Pesë prej tyre ndodhen në fshatin Breg-Lumi, Njësia Administrative Shalë, ndërkohë 6 të tjera, 3 ndodhen në Njësinë Administrative Shosh, dhe 3 të tjera ndodhen në Njësinë Administrative Pult. Le të merremi pak me 6, po themi që janë të fundit. Qendrat e votimit në njësitë administrative Shosh dhe Pult, kërkohet që të çohen në një njësi tjetër administrative. Pra, dhe sikur t'i merrnim të mirëqena ato që thamë më lart, kërkohen që të zhvendosen nga një njësi administrative tek njësia administrative tjetër, nga Shoshi në Shalë, në Theth. Nga Pulti në Njësinë Administrative Prekal, që në fakt në vendimmarrjen tuaj zoti Komisioner të datës 2 mars, keni thënë qartë “Kodi Zgjedhor nuk lejon autorizimin e transferimit të vendndodhjes të qendrave të votimit në njësi tjetër administrative”. Kjo është vendimmarrja, e cila është lënë në fuqi me një vendim të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Kështu që për njësitë administrative në Shosh dhe në Pult unë mendoj që këtë çështje e ka myllur vetë vendimmarrja juaj, e cila më pas është gjetur e drejtë dhe në përputhje me Kodin Zgjedhor nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve. Ndërkohë sa i përket njësisë administrative që ndodhet në Shalë, duhet thënë që nuk e kuptoj po themi, ku, çfarë të dhënat kemi ne, faktike, se kryetarja e Bashkisë Shkodër nuk ka sjellë asnje të dhënë. Cilat janë të dhënat faktike që provojnë faktin se banorët e fshatrave Breg-Lumi, Lekaj, nuk jetojnë po themi,


*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

nuk janë në Shalë, por do vijnë nga një zonë tjetër, dhe u dashka që atyre t'ua ofrojmë qendrën e votimit? As nuk kemi të dhëna, as nuk kemi fakte, as nuk kemi numra, as nuk kemi ndonjë konfirmim. Ne nuk mund të marrim të mirëqenë një konstatim që është bërë në mënyrë të përgjithshme nga ana e Bashkisë Shkodër. Nuk kemi këtu asnjë numër, asnjë shifër nuk shoh në shkresën 04.03.2022 që të relatojë diçka të tillë. Edhe sikur të kishim shifra do duhej që ato të vinin nga burime të sigurta. Se e tha qartazi, për ne kryetarja e Bashkisë Shkodër është palë. Është angazhuar në fushatë zgjedhore. Mund ta shikoni në rrjetet sociale, në media, që shfaqet krah njërit prej kandidatëve, dhe unë s'e kuptoj i nderuar sesi ne mund të marrim një masë. Si mund të marrim një masë për t'u mohuar të drejtën e votës qytetarëve që sot jetojnë në fshatrat Mavriq, Lotaj, Pjollaj, Gimaj, Lekaj, Vuksanaj. Si mund t'u heqim të drejtën këtyre qytetarëve që jetojnë në ato zona gjatë gjithë vitit dhe t'u themi tani nuk do votoni aty ku keni votuar gjithmonë, por do shkonit të votoni në Theth. Nuk e di në qoftë se e dini zoti Komisioner, por banorët që jetojnë në këto fshatra, u duhet nja 30 minuta deri në një orë për të arritur deri në Breg të Lumit, ku është sot qendra e votimit. Në qoftë se e çojmë në Theth do t'u duhen dhe shumë orë të tjera dhe ka rrezik deri në pamundësi për të shkuar të ushtrojnë të drejtën e votës. Do ishte shkelje e pastër e të drejtës së votës së këtyre qytetarëve. Unë nuk e di, sigurisht e di, por po them faktin, në shkresë nuk thuhet cilat janë arsyet që kryetarja e Bashkisë Shkodër kërkon t'u heqin të drejtën e votës qytetarëve të fshatrave Nënmaivriq, Lotaj, Pjollaj, Gimaj, Lekaj, Vuksanaj. U thotë këtyre që po të doni të shkonit të votoni, shkonit në Theth. E pakuptueshme, e paarsyeshme. Fakti tjetër shumë i rëndëshishëm, është fakti i nderuar që ju e dini, partitë politike janë të përfshira në administratën zgjedhore. Partia Demokratike e Shqipërisë, meqenëse unë përfaqësoj Partinë Demokratike, ka caktuar komisionerët e saj, ka caktuar vëzhguesit, dhe ata kanë marrë të gjitha masat që në datën 6 mars, madje që sot që bëhet dorëzimi i

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

materialeve zgjedhore, të jenë të pranishëm në këto qendra votimi. Nga ana tjetër siç bën çdo parti politike, Partia Demokratike ka informuar të paktën mbështetësit e saj, por jo vetëm, lidhur me vendin ku do kryhet procesi i votimit. Unë kam parë shpeshherë fushata, fushata informimi nga vetë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në rrjete sociale, por dhe media që u bën thirrje qytetarëve “informohuni për qendrën tuaj të votimit”. Çfarë duam të bëjmë ne sot? T’ua ndryshojmë qendrën e votimit në më pak se 24 orë përpara datës së zgjedhjeve? Nuk besoj që gjithë qytetarët e këtyre zonave rrinë dhe na ndjekin dhe përcjellin vendimmarjet tona. Ka shumë mundësi që nesër qytetarët e fshatrave të Njësisë Administrative Shalë do paraqiten në ato qendra votimi që janë paraqitur gjithmonë, dhe do ta gjejnë derën e mbyllur. Se po flasim për një zonë po themi, ku nuk është çështja që nuk do zhvillohen zgjedhjet në bllok, por do zhvillohen në sheshin “Skënderbej”, ose nuk do zhvillohen në sheshin “Skënderbej”, por do zhvillohen në sheshin “Nënë Tereza”. Nuk po flasim për këtë gjë, po flasim për distanca të konsiderueshme me vështirësi reale, që këta qytetarë të lëvizin nga një zonë në tjetrën, por sigurisht që ata janë të informuar dhe kanë marrë masat për të votuar në ato qendra votimi, ku kanë votuar edhe në zgjedhjet e 25 prillit. Tjetër fakt i rëndësishëm që e thashë edhe më përpara është çështja që tashmë procesi zgjedhor ka filluar. Pra, jemi në kushtin kur unë sapo kam komunikuar me disa nga anëtarët e KZAZ nr.2, të Bashkisë Shkodër dhe thonë që ka filluar shpërndarja e materialeve zgjedhore. Kështu që për arsyet ligjore që janë të parashikuara në nenin 62 dhe nenin 9, të udhëzimit të Komisionit Rregulator, neni 62 i Kodit Zgjedhor, qoftë çështja e afatit që nuk e lejon, qoftë fakti që duhet të ketë një forcë madhore. Por forcë madhore, jo reshje dëbore, se reshje dëbore e thashë, dhe po e ritheksoj, në ato zona ka pothuajse gjithmonë. Dhe qoftë për arsyet të natyrës logjike, ose dhe logistike, fakti që ne tashmë, partitë politike kanë caktuar komisionerët, vëzhguesit, kanë informuar zgjedhësit, kanë marrë masat partitë


*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

politike që mbështetësit e tyre në qoftë se e kanë të pamundur të mundësojnë ndoshta dhe transportin e tyre. Do ishte qoftë dhe për arsy politike absolutisht po, dhe për arsy politike, të cilat kanë të bëjnë me faktin që kemi një kryetare bashkie të angazhuar në zgjedhje, e cila sigurisht paraqet qëndrime pale. Shiko i nderuar, po t'i hapim rrugë kësaj praktike mund të vijnë disa banorë, ose qytetarë të Bashkisë Lushnje dhe të thonë që një pjesë e madhe e jona jeton në Greqi, na sillni një qendër votimi në Gjirokastër. Ose mund të vijë kandidati i subjektit zgjedhor “Shtëpia e Lirisë” dhe mund të thotë më sillni një qendrë votimi në njësinë 5, Tiranë, se këtu e kam shtëpinë. Mund të na ndodhë edhe kjo, por ne nuk mund të legjitimojmë kërkesa të tilla. Unë besoj që Komisioni Qendor i Zgjedhjeve ia kishte dhënë përgjigjen zonjës Ademi. E solli kërkesën, mori vendim Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vendimi nr.116, mori vendim KAS-i. Kjo është çështje e mbyllur. Për ne është e qartë që kjo është një përpjekje e pastër për të manipuluar procesin, për ta dëmtuar procesin, për të minuar irregullsinë e procesit, sepse sigurisht që në qoftë se ndryshohen qendrat e votimit sot, do duhet një riorganizim i gjithë administratës zgjedhore të paktën që mundësohet nga partitë politike, komisionerë, vëzhgues, do duhet të merret, pra them do duhet, por në fakt do ishte gati gati e pamundur, se në aq pak kohë sa kemi në dispozicion këto procese dhe sikur të vënë kapacitete njerëzore të jashtëzakonshme nuk mund të kryhen të gjitha në një kohë rekord. Kështu që për ne kërkesa që ka të bëjë me ndryshimin nga Njësia Administrative Shosh në Njësinë Administrative Shalë, dhe nga Njësia Administrative Pult në Njësinë Administrative Postribë, që janë me numër rendor 6, 7, 8, 9, 10, 11. Pra, kjo për ne ka marrë një përgjigje të qartë, të kthjellët nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, konfirmuar nga KAS-i. Ndërkohë, sa i përket pesë të tjerave është e qartë edhe në këtë rast që nuk jemi në ato kushte që parashikon ligji, pra, neni 62, pika 4, dhe neni 9, i udhëzimit të Komisionit Rregulator, për të vendosur që të

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*




*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

ndryshojmë qendrat e votimit. Është interes madhor, besoni i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është interes madhor i subjekteve politike që t'u mundësohet që qytetarët të jenë shumë të qartë, të jenë shumë të informuar se ku është qendra e tyre e votimit dhe këtë nuk mund ta bëjmë në vetëm pak orë përpara fillimit të ditës së zgjedhjeve dhe t'u mundësohet atyre që qendrën e votimit ta kenë në zonën që banojnë. Ndërkohë, nuk ka asnjë fakt që të na bëjë ne të besojmë që gjithë banorët e Njësisë Administrative Shalë paskan shkuar të jetojnë në Shkodër dhe këtë e ditka vetëm kryetarja e bashkisë dhe për këtë nuk ka asnjë fakt, apo asnjë të dhënë tjetër. Kështu që ky është qëndrimi ynë dhe unë shpresoj shumë zoti Komisioner, që kjo çështje të mos trajtohet thjesht si çështje burokratike, se ka të bëjë thelbësish me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor të 6 marsit.

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit zoti Logu! Përfaqësuesi i koalicionit?

**Z. A. Kazaj, përfaqësues i koalicionit “SH-L”:** Faleminderit zoti kryetar! Unë do mundohem të limitoj pak veten time përsa i përket pjesës së momentit aktual, në të cilin ndodhemi. Ndodhemi në momentin e heshtjes zgjedhore dhe nuk dua të bëj as propagandë politike dhe as propagandë, po themi të orientuar, për të orientuar zgjedhësit drejt një subjekti të caktuar. Përsa i përket kërkesës që ju na keni vënë në dispozicion nëpërmjet e-mail-it zyrtar dhe jemi në shqyrtim në këtë seancë publike, bëj me dije që nga parafolësi sot mësova diçka. Mësova që forca madhore nuk na qenkan forcat e natyrës, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në një aktivitet të caktuar, duke cenuar një të drejtë kushtetuese të zgjedhësve. Nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë këtë gjë. Si jurist për herë të parë po e dëgjoj. Përsa i përket pjesës së fakteve dhe provave për të cilat ky komision dhe ju si përfaqësues i këtij institucioni do dilni me një vendimmarrje, jemi totalisht dakord të themi për shkak të gjendjes së

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

jashtëzakonshme të atyre zonave. Nuk do të thotë kjo dhe nuk e lidh fare as me problemet personale që mund të ketë subjekti që foli më përpara me kryetaren e bashkisë, e cila është në ushtrimin e detyrave të veta funksionale nga momenti që nëpërmjet akteve të veta kërkon autorizimin nga ana juaj për të lejuar që 5227 votuesve të zonave për të cilat kërcohët transferimi i vendndodhjes së QV-ve t'u jepet e drejta për të ushtruar të drejtën e tyre kushtetuese për të zgjedhur. Këtë gjë në qoftë se do e marrim të mirëqenë edhe në qoftë se e kishte gabim kryetarja e bashkisë, e konfirmon vetë ZAZ-ja, i nderuar zoti kryetar! Jo më vonë se para 20 minutash zoti Meta na vuri në dispozicion, të themi dhe kërkesën e bërë nga të gjithë anëtarët e ZAZ nr. 2, ku shprehin dakordësinë e tyre, është me firmat e tyre. Shprehin dakordësinë e tyre, besoj se janë dhe anëtarët e Partisë Demokratike këtu, apo jo zoti Meta? Janë dhe anëtarët e Partisë Demokratike që kanë shprehur dakordësinë.

**Z. E. Meta:** Po!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Jo “po”, jo tani, një sekondë!


**Z. A. Kazaj, përfaqësues i koalicionit “SH-L”:** Ja ku është dokumenti!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po kërkesën e keni ju?

**Z. I. Celibashi:** Vetëm një sekondë!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Tani nuk mund të thoni thoni “po”, sepse ne jemi në proces!...

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

**Z. I. Celibashi:** Zoti Logu!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po pra, por duhet të relatohet dhe kjo është kërkesa...

**Z. A. Kazaj, përfaqësues i koalicionit “SH-L”:** Unë nuk ju ndërhyra!

**Z. I. Celibashi:** Të lutem!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Nuk po ju ndërhyj juve! E kisha me...Ju iu drejtuat administratës!

**Z. I. Celibashi:** Zoti Logu, zoti Kazaj vetëm një sekondë! Do t'ju lutesha të mos ndërhynit pa leje, se mund të pezulloj dhe mbledhjen! Dakord? Kështu që zoti Logu nëse do të keni komente të tjera do t'ju jap fjalën, kështu që pa merak! Faleminderit!

**Z. A. Kazaj, përfaqësues i koalicionit “SH-L”:** Faleminderit! ...ku thonë qartësisht që janë dakord për shkak të kushteve atmosferike dhe gjendjes së rënduar të infrastrukturës, reshjeve të borës. Pra forca madhore çfarë është? Është dhe kjo! Nuk është interpretimi që na bëri kolegu! Komisioneri është krejtësisht në ushtrimin e funksionit dhe detyrave që njeh ligji. Komisioneri po zbaton vetë kërkesat edhe vetë në bazë të një deklarate publike tuajën zoti Komisioner, ku kishit ngritur shqetësimin ditën e djeshme për *quazi* pamundësinë për zhvillimin e procesit të votimit në këto zona dhe ne jemi plotësisht dakord për shkak se e njohim mirë zonën, kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësuesit tanë edhe politikë, por dhe teknikë të asaj zone, ku të gjithë dakordësojnë për faktin që me shumë probabilitet në qoftë se do

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*




*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

liheshin qendrat e votimit në këto zona, procesi zgjedhor atje do minohej dhe nuk do të kishte garanci, ose do kishte zero garanci për zhvillim. Po ashtu dua të dal pak dhe nga rendi i ditës. Kaq kisha dhe për këtë pjesë, në qoftë se mundem zoti Komisioner?

**Z. I. Celibashi:** Të përfundojmë këtë pikë pastaj vazhdojmë me çështje të tjera jashtë rendit të ditës. Po zoti Logu, fjala për ju!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Celibashi! Kërkoj ndjesë për ndërprerjen e mëparshme por fakti është që ne na është vënë në dispozicion një kërkesë, e datës 05.03.2022, të KZAZ nr. 2, të Bashkisë Shkodër, në të cilën tre anëtarë përkatesisht dhe kryetari, janë shprehur kundër propozimit të Bashkisë Shkodër lidhur me këtë pjesë. E di që ka ardhur një kërkesë ku janë shprehur, ku ka pasur po themi, një dakordësi të të gjithë anëtarëve. Unë kam pasur komunikim me tre prej anëtarëve, ata thonë që kjo është një kërkesë, një shkresë e manipuluar. Unë nuk besoj tani që mund t'i hyjmë këtu ne vërtetësisë së faktit apo jo, por ajo që rezulton është që dhe në qoftë se ka pasur një vendimmarrje administrativisht të paktën, vendimmarrje të mëparshme, vendimmarrja e dytë shfuqizon të parën dhe jemi në këto kushte, pra, kur nuk ka dakordësi as nga ana e anëtarëve të KZAZ-së dhe as nga ana e subjekteve zgjedhore për të kryer këtë ndryshim. Anëtarët e KZAZ-së, por veçanërisht subjektet zgjedhore kanë një rol shumë të rëndëshishëm në administrimin e procesit zgjedhor dhe mendimi i tyre, mendoj unë, nuk është vetëm çështje opinioni, por është edhe çështje mundësish reale që kanë ata për t'iu përgjigjur kërkesave që ka procesi. Nga ana tjetër i nderuar, unë mendoj që ato që ka konstatuar me të drejtë Komisioni i Ankimoreve dhe Sanksioneve në vendimin nr.11, datë 4 mars 2022 duhen sjellë në vëmendje. Thuhet “në momentin e caktimit të qendrave të votimit kanë qenë të njoitura për kryetarin e bashkisë, si stina, kushtet

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*




*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

gjeoatmosferike, mundësitë e telekomunikacionit” etj, etj, ashtu dhe sjelljet e banorëve, por thotë “nga momenti që është paraqitur kjo shkresë”, pra e datës 28 janar, deri në momentin e paraqitjes së saj, nuk ka ndodhur asnjë ndryshim, asnjë rrëthanë që mund të ketë lidhje me ngjarje të forcës madhore. Pra, nuk është se në këtë periudhë të caktuar kohore, sepse i referohet vetëm periudhës, ngjarja e forcës madhore duhet të ketë ndodhur në këtë periudhë, nga momenti që janë caktuar deri në momentin që kërkohet ndryshimi. Nuk ka gjëra të forcës madhore. Aq më tepër që beson dhe është logjika që në datën 28 janar reshjet dhe problematikat kanë qenë nga më të fortat në atë periudhë, sesa mund të jenë sot që po i afrohemë pranverës. Arsyet tjetër e rëndësishme i nderuar, sepse përdoret, thuhet në shkresën e dërguar nga kryetarja e bashkisë, është fakti që nuk mund të thuhet që mungesa e energjisë elektrike e pretenduar është forcë madhore. Problemet e infrastrukturës janë forcë madhore, se pastaj domethënë këtu do ishim, do ishte iluzion e gjitha.

**Z. I. Celibashi:** Të lutem zoti Logu, se këtyre pretendimeve u kemi dhënë, jemi shprehur me vendimmarrje!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ka një informacion të ri të rëndësishëm. Administrata e KQZ-së sot konfirmoi në seancë se OSHEE ka garantuar furnizimin me energji elektrike të të gjitha qendrave të votimit. Është e rëndësishme. Pra, konfirmon një fakt nga një palë e tretë. Nga ana tjetër KQZ-ja, ose administrata ka garantuar shpërndarjen e materialit zgjedhor, prezencën e komisionerëve në qendrat e votimit dhe funksionimin e tyre të rregullt në ditën e votimit. Pra, siç shohim zoti Komisioner, KQZ-ja konfirmon që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor të 6 marsit dhe nuk ka asnjë lloj arsyjeje, të natyrës të paktën ligjore apo logjike, për të ndryshuar në pak orë përpara fillimit të procesit

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

zgjedhor, qendrat e votimit. Kështu që qëndrimi ynë është shumë, po shumë i qartë në këtë pikë, sa i përket kundërshtimit absolut që kemi lidhur me këtë ndryshim të mbështetur në gjithë këto shkresa, por edhe bazën ligjore që patëm mundësi besoj të parashtrojmë gjerësisht përpara komisionit.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit zoti Logu! Erion, marrë në konsideratë dhe atë çfarë replikoi zoti Logu, ne kemi dy akte nga KZAZ-ja, kemi një akt të sjellë dje, sipas të cilis të gjithë anëtarët e KZAZ-së kanë marrë një vendim në unison, unitet të plotë në lidhje me zhvendosjen e qendrave të votimit, ndërsa sot kemi një vendim tjetër nga KZAZ-ja ku rezulton që 3 anëtarë të KZAZ-së nuk janë dakord nga shtatë. Kështu është situata?

**Z. E. Meta:** Konfirmoj! Po!

**Z. I. Celibashi:** Në rregull! Ne dje kemi kërkuar që një përfaqësues i KQZ-së nga Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore, të bëjë një verifikim në terren të situatës. Kemi një raport? Se në dijeninë time kemi një raport në lidhje me situatën në terren të aksesit rrugor, apo tjetër në qendrat e votimit, objekt shqyrthimi. Shumë shkurt të lutem!

**Z. E. Meta:** Po, personi i kontraktuar ka raportuar që në qendrat e votimit Breg-Lumi, Shalë, Shosh, Pult nuk ka energji elektrike dhe rruga është shumë e vështirë për t'u kaluar, dhe vende-vende është e pakalueshme. Gjithashtu, ka paraqitur edhe pamje fotografike.

**Z. I. Celibashi:** Bëhet fjalë për të 11 këto qendra votimi, apo për një pjesë të tyre?

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

**Z. E. Meta:** Për një pjesë të tyre!

**Z. I. Celibashi:** Po! Edhe ne e kemi këtë informacion se cilat qendra votimi janë?

**Z. E. Meta:** Ende nuk e ka sjellë të detajuar informacionin.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Pamundësia po themi, ose vështirësia në lëvizje  
është brenda territorit të qendrës së votimit, apo kur vjen nga një njësi tjetër  
administrative për të hyrë?

**Z. E. Meta:** Vëshirësia është në zonën e Pultit, e raportuar konkretisht!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Vetëm në zonën e Pultit ka këto vështirësi? Në  
Njësinë Administrative Shalë dhe Njësinë Administrative Shosh nuk janë këto  
vështirësi?


**Z. E. Meta:** Ka vështirësi, por nuk e ka detajuar.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Është informacion i pjesshëm?

**Z. E. Meta: Po!**

**Z. I. Celibashi:** Edhe një sqarim tjetër. Për 7 qendra votimi, këto të Shalës,  
propozohet zhvendosja brenda së njëjtës njësi administrative dhe janë zona të  
qendrës së votimit fqinje me njëra-tjetrën dhe brenda së njëjtës njësi administrative.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

**Z. E. Meta:** Bëhet fjalë për 5 qendra votimi që janë në njësinë Shalë, në fshatrat Breg-Lumi, Lekaj dhe që kalojnë në Theth, të së njëjtës njësi. Bëhet fjalë për qendrat e votimit 116, 117, 118, 119, 119/1.

132 dhe 133 janë të Njësisë Administrative Shosh.

**Z. I. Celibashi:** Po 0091 në Kir, 0092 në Bruçaj, 0093 që janë të Pultit dhe 0094 Pult, propozimi është për të shkuar në?


**Z. E. Meta:** Në njësinë administrative, ose në zonën më të afërt fqinje në Postribë.

**Z. I. Celibashi:** Ekzaktësish në Prekal. Dakord!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Një pyetje zoti Celibashi? Nga raportimi, se në fakt do ishte mirë që atë raportimin ta kishim edhe ne, duke qenë se sillet si provë besoj në këtë proces, nga raportimi i zotit Meta, rezulton që nga fshati Breg-Lumi, në fshatin Theth, si është gjendja e infrastrukturës rrugore? Ka vështirësi në lëvizje? Se kjo është zona, po themi të paktën edhe duke e njobur zonën, që kjo është zona më e thellë e mundshme. Pra, nga pjesa e Breg-Lumit deri në Theth, është kjo si segment rrugor, si rezulton gjendja?

**Z. E. Meta:** Nuk kam raportim. Për sa informacion keni dhe ju aktualisht nga raportuesi, por di t'ju them që në këto zona përgjatë periudhës së sesionit të trajnimeve janë raportuar nga traineri bllokime të rrugës dhe kishte pamundësi për zhvillimin e trajnimeve.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Sepse shoh informacionin zoti Komisioner, edhe më lejoni t’ju them që është një kështu...janë më pak se tri fjali. Dhe thuhet “vende-vende të pakalueshme” fotot janë bërë në rrugët deri në Pult. Pra, deri në Pult ka vajtur zonja Hebovija. Nuk ka informacion të mëtejshëm dhe nuk ka asnë informacion sa i përket aksesit që mund të kenë nga fshati... Pra, një qytetar që jeton, po marr Lekaj, dhe voton në Breg-Lumi, sa të mundur e ka që të vijë të votojë në Theth? Se ky është koncepti, të paktën siç e kupojmë ne, i aksesit, se fakti që qytetarët e tjerë që jetojnë në bashki të tjera, mund të vijnë të votojnë, kjo është një gjë që unë mendoj se pastaj do hapim një diskutim për të gjitha qendrat e votimit. Kështu që në këto kushte kërkoj që të vlerësohet specifisht kjo gjë. Në qoftë se ne po marrim si shkak, ose si arsy, faktin që ka vështirësi në lëvizje, besoni që ka shumë vështirësi të madhe të lëvizësh nga fshati i Breg-Lumi në drejtim të fshatit Theth që rezulton që është zona më e thellë e mundshme dhe rrugët mund të jenë të vështira, por këtu jemi gjithmonë në kuadër të aludimit, se ne nuk kemi informacion për këtë gjë dhe informacioni që ka sjellë zonja Hebovija në fakt është krejtësisht minimalizëm dhe që nuk duhet të merret në cilësinë e provës nga ana e Komisionerit në vlerësimin e tij.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Dhe një pyetje kam Erion. Dje gjithë anëtarët e KZAZ-së janë dakordësuar për mënyrën sesi do të bëhej zhvendosja e qendrave të votimit dhe pjesërisht ajo çfarë ata kanë vendosur përputhet me kërkesën e dytë të sjellë nga Bashkia Shkodër. Sot, tre prej atyre anëtarëve kanë sjellë një vendimmarrje tjetër, kanë sjellë një vendim tjetër të tyre. Kemi bërë ndonjë pyetje, përsë jemi në këtë situatë?

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

**Z. E. Meta:** Po, dhe kanë raportuar që kanë pasur kohën e nevojshme të mendojnë dhe të reflektojnë.

**Z. I. Celibashi:** Po nuk ka pretendime në lidhje me nënshkrimet?

**Z. E. Meta:** Jo!

**Z. I. Celibashi:** Thjesht që dje kanë vlerësuar ndryshe, sot po e vlerësojnë ndryshe, për shkak të kohës. Kanë patur më shumë kohë për të arsyetuar më mirë vendimmarrjen e tyre dhe sot kanë ardhur me një opinion tjetër.

**Z. E. Meta:** Po!


**Z. I. Celibashi:** Dakord, faleminderit! Pra, nuk kemi ndonjë pretendim në lidhje me nënshkrimet?

**Z. E. Meta:** Nuk ka pretendim në lidhje me vërtetësinë e dokumentit.

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Po zoti Logu!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Domethënë edhe shkresa së cilës i referohemi besoj të gjitha palët, ka një dakordësi për tri qendrat e votimit që ndodhen në Njësinë Administrative Pult që do zhvendosen në Njësinë Administrative Postribë, që në vlerësimin tonë është tërësisht në kundërshtim me ligjin, si dakordësi. Nga ana tjetër nuk ka dakordësi që qendrat e votimit, që u referohet tri qendrave të votimit në Shosh, të zhvendosen në Shalë, dhe kemi këtu parasysh, që po flasim për distanca

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

jashtëzakonisht të konsiderueshme, duke pasur parasysh terrenin ku zhvillohen. Ndërkohë, lihet i hapur fakti që ka të bëjë me njësitë administrative që ndodhen, qendra e votimit që ndodhet në Njësinë Administrative Shalë. Pra, nuk ka një dakordësi të plotë edhe në atë shkresë që i referohet ditës së djeshme, por një dakordësi të pjesshme për disa rrethana, e cila në vlerësimin tonë zoti Komisioner, është po ashtu në shkelje të ligjit. Unë mendoj që edhe në qoftë se ka pasur një vendim të mëparshëm të KZAZ-së nr. 2, vendimi i mëvonshëm revokon vendimin e mëparshëm, dhe këtu jemi në një praktikë normale administrative besoj, sa i përket se cili duhet të jetë vendimi, ose akti administrativ që ne duhet të marrim në konsideratë.

**Z. I. Celibashi:** Në pikëpamje formale vendimi është i njëjtë, por vetëm se në rastin e parë është marrë me konsensusin e të gjithë anëtarëve, në rastin e dytë vetëm 4 anëtarë të KZAZ-së kanë votuar, dhe 3 janë kundër. Vendimmarrja nuk ka ndryshuar në pikëpamje formale, është e njëjta vendimmarrje.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Mendoj që mbarëvajtja e procesit zgjedhor kërkon një lloj po themi, konsensusi të të gjitha palëve sepse...

**Z. I. Celibashi:** Kjo është tjetër gjë, por jam dakord me këtë!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** E ripërsëris edhe njëherë, po themi që subjektet zgjedhore të cilat kanë të drejtë të delegojnë, ose të emërojnë anëtarë në KZAZ-të përkatëse kanë një rol thelbësor në administrimin dhe mbarëvajtjen...

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

**Z. I. Celibashi:** Jo, jo jam dakord, por ishim tek kjo që në pikëpamje formale është i njëjti vendim, nuk ka ndryshuar vendimi i KZAZ-së, por gjithsesi unë jo më kot e bëra pyetjen, për të kuptuar dinamikën e të dy vendimeve. Në rastin e parë vendimi ishte me konsensus, në rastin e dytë ishte me shumicë. Pra, të dyja si vendime janë të vlefshme. Kështu që ne do ta vlerësojmë këtë gjë, por fakti ky është.


**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Pasi erdha në komision u vura në dijeni të të dy shkresave. Nuk kam pasur dijeni, megjithëse pretendohet që shkresa, njëra nga këto ka ardhur që ditën e djeshme, kështu që në ato pak kohë sa patëm mundësi të sigurojmë informacion dhe është dhe ky opinion që po japim, sepse po të kishim patur një kohë më të gjatë...

**Z. I. Celibashi:** Jo, edhe ata e kanë pranuar, kanë thënë që dje kemi vendosur kështu, sot kemi vendosur ndryshe, sepse kemi patur kohë më shumë për të arsyetuar më mire dhe askush, as unë, askush nuk i paragjykon dot. Janë të lirë të shprehin mendimet dhe të disponojnë si të duan mbi çështje të caktuara, por fakti është ky. Pra, do ishte ndryshe nëse ajo vendimmarrje e djeshme me konsensus të plotë nuk do të ishte në përputhje me parashikimet e ligjit. Pra, ato tre firma, të cilat sot janë kundër, nuk janë firmat e tyre dhe nuk janë vullneti i tyre. Dje ka qenë vullneti i tyre, janë në të drejtën e tyre ta ndryshojnë vullnetin e tyre, s'ka asnje lloj problemi përkëtë dhe unë nuk kam asnje lloj paragjykimi përkëtë çështje.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Në çdo rast i nderuar unë mendoj që kjo kërkesë nuk është se ka ndonjë vlerë ligjore...

**Z. I. Celibashi:** Është tjetër gjë ajo, unë thjesht doja të konfirmoja këtë.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** As Kodi Zgjedhor dhe as akti nënligjor i nxjerrë nga Komisioni Rregulator nuk kërkon që KZAZ-ja të shprehë ndonjë opinion të saj. Kjo është në çdo rast një iniciativë që ata e kanë marrë.

**Z. I. Celibashi:** Zoti Logu nuk thashë asgjë të kësaj natyre, thjesht kaq! Domethënë për këtë jemi dakord që vendimi nga pikëpamja formale është i vlefshëm, si ai dje dhe ai sot. Ai dje ishte me konsensus, ky sot nuk është me konsensus, kaq!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit “SH-L”:** Do më falni vetëm një gjë, është ora 13:30, ne po gjejmë...


**Z. I. Celibashi:** E fundit dhe do ta mbyllim zoti Kaziaj kështu që kërkojmë mirëkuptimin tuaj!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i koalicionit “SH-L”:** ...duke minuar procesin e votimit me interesa që se di se ku janë, ndërkohë që po shkelim një të drejtë kushtetuese të atyre zgjedhësve.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti Celibashi, i kujtoj zotit Kaziaj që shkresën nuk e ka sjellë Partia Demokratike, e ka sjellë zonja Voltana Ademi, kryetare e Bashkisë Shkodër që mbështet kandidatin e subjektit zgjedhor që përfaqëson zoti Kaziaj. Nuk jemi në asnje lloj...

**Z. I. Celibashi:** Jam i sigurtë që deri në 2023-shin po të vazhdojmë me këtë argument ju keni energji dhe vullnet që të replikoni me njëri-tjetrin, por do ta mbyllim tanë

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*


diskutimin mbi këtë çështje dhe ju kërkoj 10 minuta kohë për të arsyetuar dhe për të vendosur, faleminderit!

**Rifillon seanca**

**Ora 14:00**

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë arsyetimi në lidhje me gjithë këtë diskutim dhe vendimmarrja ime përkatëse është si vijon. Mendoj që kërkesa për të bërë ndryshimin e qendrave të votimit, të 11 qendrave të votimit është e arsyetuar dhe bazuar në ligj vetëm pjesërisht, edhe pse për të gjitha ekziston arsyetimi mbi forcën madhore për shkak të situatës së motit, një gjë që është tërësisht e verifikuar dhe nga verifikimet që kemi bërë ne në terren. Pra, qëndron si argument, por ndërkohë parashikimet e Kodit Zgjedhor kanë disa kufizime dhe ndalime, të cilat lidhen me zgjidhjen e kësaj situate. Pra, kur jemi në rastin e forcës madhore, dhe këto kufizime konsistojnë atë që zhvendosja e qendrës së votimit, e vendndodhjes së qendrës së votimit nuk mund të bëhet në një zonë të qendrës së votimit që nuk është fqinje e asaj zone të qendrës së votimit, e cila do të zhvendoset. Ndaj ne do të konsiderojmë vetëm ato rastet e propozuara, tek të cilat zhvendosja e qendrave të votimit bëhet në zonën e qendrës së votimit fqinje, por dhe kjo me kushtin që të mos jetë jashtë njësisë administrative përkatëse. Në kërkesën e parë që ka bërë kryetarja në detyrë e Bashkisë Shkodër, propozimi konsistonte në zhvendosjen e vendndodhjes së qendrave të votimit në një njësi tjeter administrative, e cila nuk ishte as edhe fqinje e njësive administrative ku aktualisht janë të vendosura qendrat e votimit. Në

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*


*Dt 05.03.2022*

propozimin e dytë propozimi konsiston zhvendosjen në zonat e qendrës së votimit fqinje, por në disa raste zonat e qendrës së votimit janë jashtë njësisë administrative ku gjenden aktualisht. Edhe në interpretimin që ne i kemi bërë Kodit Zgjedhor, edhe në rastin e parë kemi thënë që nuk mundet të vendosen në zonat e qendrës së votimit, të cilat gjenden jashtë zonës së njësisë administrative përkatëse. Kështu që i qëndrojmë të njëjtit arsyetim që i kemi bërë në vendimmarrjen e pare. Duke e përbledhur të gjithë këtë arsyetim, në rezultante do të japim autorizimin për të bërë zhvendosjen e qendrave të votimit 0116, 0117, 0118, 0119 dhe 0119/1, të cilat janë në fshatin Shalë, dhe shkojnë në Theth, brenda së njëjtës njësi administrative. Për të tjerat nuk do të japim autorizim, për qendrat e tjera të votimit. Në këtë mënyrë besoj që jemi jo vetëm në përputhje të plotë me parashikimit e Kodit Zgjedhor, por dhe me arsyetimin dhe qëndrimin e mëparshëm që kemi mbajtur në lidhje me këtë çështje. Me këtë rast duhet të koordinojmë me KZAZ-në për shpërndarjen e bazës materiale edhe me organet e qeverisjes vendore, por edhe me struktura të tjera shtetërore, me policinë dhe me forcat e ushtrisë, të cilat vënë në dispozicion mjetet, automjetet përkatëse për të shpërndarë bazën materiale dhe partitë politike, subjektet zgjedhore të cilat kanë propozuar anëtarë për komisionerë në këto qendra votimi, të marrin masa për t'i patur prezentë njerëzit për të marrë në dorëzim bazën materiale dhe të koordinojmë edhe transportin për këto qendra votimi, si ato të cilat dhanë autorizimin për zhvendosje, po ashtu dhe për ato qendra votimi, të cilat nuk autorizuam zhvendosjen e tyre. Arsyetim tjetër dhe diskutim tjetër në lidhje me këtë çështje nuk kemi kështu që e konsiderojmë të mbyllur këtë pikë të rendit të ditës në lidhje me vendimmarrjen.

**Vendim nr. 128**

*Zbardhi materialin audio*

*Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

05.03.2022  
Ora 14:05

**JASHTË RENDIT TË DITËS**

**PJESËMARRJA :**


• **KQZ**

- 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      Z. Ilirjan Celibashi  
2.Stafi KQZ:    Y. Merkaj, E. Meta  
• Parti Politike:                                        PD, Koalicioni "Sh-L"

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me çështje të tjera jashtë rendit të ditës, po zoti Logu!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Qëndrimi ynë për vendimmarrjen që ju sapo morët, dihet. Sigurisht që është vendimi juaj dhe ne tashmë nuk do diskutojmë vendimmarrjen tuaj që ka të bëjë me pranimin pjesërisht të kërkesës së Bashkisë Shkodër, vetëm për pesë nga 11 qendra votimi, që është kërkuar zhvendosja. Megjithatë dëshirojmë t'ju informojmë zyrtarisht zoti Komisioner që Partia Demokratike do ushtrojë menjëherë të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi pranë Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve, që i bëj thirrje meqenëse jemi në Komisionin Qendor të Zgjedhjeve, të mblidhet menjëherë për të shqyrtaur ankimin që ne do të paraqesim brenda jo më shumë sesa dy orëve nga mbyllja e kësaj mbledhjeje, dhe kërkojmë që në kushtet kur do ketë një mbledhje dhe një vendimmarrje të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve mos të fillojë shpërndarja e materialeve zgjedhore, pasi një vendimmarrje e ndryshme e Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve, siç e besojmë do jetë, do të sillte më pas edhe njëherë lëvizjen, apo transferimin e materialeve zgjedhore nga një pikë në

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*




*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

pikën tjetër. Kjo është çështja e parë, të cilën unë do të kérkoja që të vlerësohej nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Çështja e dytë i nderuar, ka të bëjë me faktin që ne në fakt kemi kërkuar nga një komunikim që kam pasur me administratën e KQZ-së të na vihet në dispozicion lista e operatorëve që do administrojnë, ose përgjegjës për pajisjet PEI në Bashkinë Shkodër dhe deri më sot nuk na është vënë në dispozicion ky dokument. Do kërkonim që ky dokument të na vihej në dispozicion. Ne nuk vlerësojmë që përbën asnjë të dhënë konfidenciale. Emrat e personave që merren me administrimin e procesit zgjedhor janë publikë dhe nuk ka asnjë lloj, po themi, cenimi të mbrojtjes së të dhënave personale apo ndonjë rrisk tjetër. Kjo bëhet nga ana jonë si subjekt zgjedhor vetëm e vetëm për të garantuar, pra për një lloj *check-in-i* dhe nga ana jonë, dhe për të qenë të sigurtë që të gjithë operatorët që do angazhohen në procesin zgjedhor të datës 6 mars janë emëruar në përputhje me kërkeshat ligjore. Pra kjo kërkeshë i shërben mbarëvajtjes së procesit zgjedhor. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë në lidhje me kërkeshën e parë edhe nga pikëpamja praktike do kemi vonesa se do marrë kohën e vet procesi i dorëzimit, por gjithsesi nuk do ta dërgojmë në destinacion derisa të kemi një vendimmarrje të KAS-it, me kushtin që në çdo rast kjo të ndodhë deri nesër, teorikisht në orën 07:00. Dakord? Kështu që do koordinojmë për këto pesë qendra votimi, se pjesa tjetër, thamë që do duhet të merren masa që duhet shpërndarja e bazës materiale, ashtu sikurse janë qendrat e votimit të vendndodhura. Në lidhje me kërkeshën për listën e operatorëve, patjetër, besoj se nuk ka ndonjë problem, por pa numra personalë të identifikimit besoj? Thjesht emër, mbiemër?

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Patjetër, vetëm emër, mbiemër. Nuk ka nevojë pér të dhëna të tjera!

**Z. I. Celibashi:** Po, do t'ju vihet në dispozicion menjëherë. Këtë nuk e kemi në internet, listën e operatorëve? Nuk e kemi? Në rregull, atëherë të jepet menjëherë! Po, përfaqësuesi i koalicionit!

**Z. A. Kazaj, përfaqësues i koalicionit “SH-L”:** Vetëm një saktësim. KAS nuk vihet në lëvizje nëpërmjet deklaratave publike. Vihet në lëvizje nëpërmjet kërkesave ankimore, sipas procedurës ligjore dhe pavarësisht, të themi iniciativës tonë si parti, nuk mundet të marrë Komisioneri vendimmarrje nga momenti që nuk është depozituar një kërkesë ankimore pér vënie në lëvizje të KAS-it nëpërmjet kundërshtimit të vendimmarrjes suaj. Po ashtu dua të përfitoj nga rasti, jashtë rendit të ditës të vë në dijeni Komisionerin se sot në ditën e heshtjes zgjedhore, shumë media vizive kanë transmetuar disa veprimtari të qeverisë shqiptare ku promovojnë punët publike të qeverisë shqiptare, kryesisht në qarqet që do shkojnë në votime ditën e nesërme. I lutem administratës të verifikojë dhe të marrë masa përkatëse në këtë rast.

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit zoti Kazaj! Besoj pér atë të parën nuk ka nevojë pér përgjigje. Përsa i përket kërkesës së dytë, t'i dërgohet një njoftim, ose sjellja në vëmendje të gjitha televizioneve, apo radiove që janë në kushtet e thyerjes së Kodit Zgjedhor nëse transmetojnë aktivitete elektorale sot dhe nesër, përfshirë dhe aktivitete, të cilat janë aktivitete të qeverisë, por që në kushtet e heshtjes zgjedhore ato mundet të janë të tillë që përcjellin mesazhe elektorale, veçanërisht në 6 bashkitë

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

ku do të zhvillohen zgjedhjet. Këtë listën e operatorëve mund ta dërgojnë dhe me e-mail, nuk ka problem besoj.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Në vendimin nr.2, datë 22 janar 2022, Komisioni Rregulator ka përcaktuar që ndryshe nga rregulli i përgjithshëm në Kodin Zgjedhor, brenda afatit treditor përpara datës së zgjedhjeve nuk mund të publikohen sondazhe. Ditën e enje një media ka publikuar një sondazh, i cili do kërkojmë të vlerësohet në qoftë se është brenda afatit treditor. Ne vlerësojmë që dita e enje, e premte dhe e shtunë janë tri ditë brenda të cilave nuk duhet publikuar asnjë lloj sondazhi, ndërkohë që rezulton që nga një media është publikuar, i cili më pas dhe është shpërndarë në media të tjera, është publikuar një sondazh lidhur me procesin zgjedhor të datës 6 mars. Informacionin do t'jua vëmë në dispozicion edhe me shkresë, lidhur me detajet e këtij publikimi.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Mirë, atëherë e mbyllim seancën për këtë çështje. Jemi në kontakt për çdo problematikë që vlerësoni se mund ta adresoni.

**Z. E. Meta:** Është një kërkesë nga Bashkia Durrës për ndryshimin e qendrave të votimit.

**Z. I. Celibashi:** Një kërkesë nga Bashkia Durrës! Janë njojur përfaqësuesit e partive?

**Z. E. Meta:** Jo, se besoj, sepse tani sa erdhi!

**Z. I. Celibashi:** Në rregull! Atëherë ua prezantojmë dhe përfaqësuesve të partive politike kërkesën për zhvendosje. Për 15 minuta. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

**05.03.2022  
Ora 14:51**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim “Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së dy qendrave të votimit në Bashkinë Durrës, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022”.**

**PJESEMARRJA :**

• **KQZ**

- |   |                              |
|---|------------------------------|
| <b>1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve</b> | <b>Z. Ilirjan Celibashi</b>  |
| <b>2.Stafi KQZ:</b>                         | <b>Y. Merkaj, E. Meta</b>    |
| <b>• Parti Politike:</b>                    | <b>PD, Koalicioni “Sh-L”</b> |

**Z. I. Celibashi:** Po! Atëherë në lidhje me kërkesën për dy qendrat e votimit në Durrës?

**Z. E. Meta:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 47, datë 7 shkurt 2022 “Për caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private për zgjedhjet e pjesshme vendore, për kryetar bashkie, në bashkitë Shkodër, Durrës, Dibër, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, të datës 6 Mars 2022”, miratoi vendndodhjet e disa qendrave të votimit në ndërtesa private bazuar në propozimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga kryetarët e bashkive. Për qendrat e votimit nr. 1347 dhe 1347/1, i miratuar me vendimin e sipërcituar, me vendndodhje në lokalin në pronësi të zotit Sefer Hoxha, në administratën e KQZ-së janë raportuar shqetësimet nga subjekti politik Partia Demokratike në lidhje me vendndodhjen e kësaj qendre votimi, i cili ishte një ambient i një anëtari të Partisë Socialiste. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar kërkesa e Bashkisë Durrës për propozim

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

për ndryshimin e vendndodhjes së dy qendrave të votimit, nr. 1347 dhe 1347/1 nga lokal i zotit Sefer Hoxha në ambientet si më poshtë: Qendra e votimit 1347 jep autorizim për zhvendosjen në lokalin e zotit Florian Tila dhe qendra e votimit nr. 1347/1 të jepet autorizim për zhvendosje në lokalin e zotit Hekuran Elezi. Bashkia referon se pronari i ambientit, zoti Sefer Hoxha është përfaqësues i një subjekti politik dhe nuk mund të shërbejë si një qendër votimi, pasi shkelen dispozitat e Kodit Zgjedhor. Bashkëlidhur projektvendimi.

**Z. I. Celibashi:** Nga verifikimet që kemi bërë ne si KQZ rezulton që këto dy qendra votimi kanë qenë në lokalin e një simpatizanti të Partisë Socialiste. Kemi verifikuar ambientet e reja ku propozohen për të shkuar?

**Z. E. Meta:** Po, janë verifikuar! Janë në ambiente të aksesueshme dhe 20 metra larg nga vendndodhja ekzistuese.

**Z. I. Celibashi:** Dhe nuk kemi probleme?

**Z. E. Meta:** Nuk ka asnjë problem dhe madje janë të aksesueshme për persona me aftësi të kufizuar, pasi një prej këtyre qendrave të votimit ka dhe persona me aftësi të kufizuar.

**Z. I. Celibashi:** Në rregull, shumë mirë! Po me KAZA-në kemi komunikuar?

**Z. E. Meta:** Po, edhe kanë konfirmuar!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 05.03.2022*

**Z. I. Celibashi:** Kanë konfirmuar dhe anëtarët e KZAZ-së! Mirë, dakord! Kemi ndonjë diskutim? Nuk kemi! Atëherë e miratojmë zhvendosjen e vendndodhjes së këtyre qendrave të votimit atje ku janë propozuar nga Bashkia Durrës, dhe ndërkokë duhet të komunikojmë për shpërndarjen e bazës materiale. Janë ngritur KQV-të për këto të dyja?

**Z. E. Meta:** Po!

**Z. I. Celibashi:** Janë ngritur! Dakord, faleminderit! Tjetër gjë nuk kemi! Mirë, faleminderit, e mbyllim!

Vendim nr. 129

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*

